



EDUKIMI MJEDISOR



Edukimi mjedisor natyror i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike mjedisore si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Edukimi mjedisor është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e shqetësimeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese dhe, mbrojtjen e dashurinë për natyrën.

“Fillimi është pjesa më e rëndësishme e punës”

Platoni

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes kësaj përmbledhjeje mujore Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, përgjatë muajt janar 2024, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin; atyre që ndodhen pranë ZM-ve, në zonat rurale. Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **520**

24 Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar **12**

2 Universitete të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara **26**



“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Specialistët e AdZM-së Berat zhvilluan një orë në shkollën 9-vjeçare "Xhemal Çekini, me temë "Dita Botërore e Edukimit Mjedisor". Përmes bashkëbisedimit me nxënësit e kësaj shkolle treguam se çfarë duhet të bëjmë për një jetë cilësore dhe të sigurtë, për veten, njerëzit që na rrethojnë dhe mjediset tona të përbashkëta.

jetë cilësore mjedise të përbashkëta

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, u zhvillua një orë mjedisore me nxënësit e klasës së 12-të, gjimnazi “Shishtavec”. Në mjediset e Parkut Natyror “Korab-Koritnik” nxënësit u njohën me vlerat natyrore dhe turistike që parku ruan.

27 janar 2024, Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

Në kuadër të 101 vjetorit të krijimit të Shërbimit Pyjor në Shqipëri, stafi i AdZM-së Kukës realizoi një aktivitet në mjediset e shkollës 9-vjeçare “Beslidhja e Malsisë” në Bajram Currë. Përmes këtij aktiviteti synuam të sjellim në vëmendjen e nxënësve, rëndësinë që kanë pyjet, duke shërbyer si një strehë e përhershme e faunës së egër.

shërbimi pyjor strehë e faunës së egër

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



25 janar 2024, Orë mjedisore

Specialistët e AdZM-së Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Myrteza Pengili” në Krujë. Me fëmijët u ndanë informacione të rëndësishme mbi mjedisin. U zhvilluan lojra dhe disa pyetësorë. Përmes lojës, fëmijët mësojnë mënyrat se si mund të mbrojnë mjedisin në tërësi.

26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Stafi i AdZM-së Durrës bëri të mundur mbjelljen e 100 fidanëve pishë mesdhetare në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Arbëria” të fshatit Halil në Krujë. Ky aksion u realizua në zonën e Zgërdheshit, pjesë e Peizazhit të Mbrojtur “Krastë-Verjon”. Veprimet konkrete si: mbjellja, pastrimi, përmirësimi i mjedisëve e peizazheve është një model shumë i mirë, për të afruar nxënësit me natyrën.

peizazh i mbrojtur pishë mesdhetare

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



17 janar 2024, Orë mjedisore

Me ftesë të një grupi nxënësish nga Shkolla e Mesme "Kostandin Kristoforidhi" në Elbasan, u realizua një orë mjedisore, e dedikuar Parkut Kombëtar "Shebenik". Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me vlerat mjedisore dhe natyrore të këtij parku. Ata u informuan rreth faunës dhe florës, e cila është shumë e larmishme, rreth monumenteve të natyrës dhe destinacioneve të shumta që parku ofron për të gjithë vizitorët që dëshirojnë të shijojnë nga afër bukuritë natyrore të tij. Në fund ata shprehën dëshirën për të realizuar një guidë turistike në park, për të eksploruar destinacionet më të bukura të tij.

26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Edukimi mjedisor është mënyra më e bukur për të afruar brezin e ri me natyrën, duke përcuar tek ata dashurinë dhe kujdesin ndaj saj. Specialistët e AdZM-së Elbasan, realizojnë gjithmonë orë të tilla mjedisore, të cilat herë pas here i kombinojnë ato edhe me guida turistike në destinacione të ndryshme të Parkut Kombëtar "Shebenik". Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, u realizua një guidë me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar "Shefqet Dosku" Dorëz, në një nga destinacionet e parkut. Nxënësit u njohën me Zonat e Mbrojtura, si dhe kaluan një ditë ndryshe në bashkëpunim edhe me organizatën Ecoalbania.

27 janar 2024, Dita e Shërbimit Pyjorë

AdZM Elbasan me stafin e saj është gjithmonë pranë ekonomive pyjore, duke punuar dhe dhënë kontribut në shtimin e sa më shumë hapësirave të gjelbra. Këtë herë, ishim me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar "Shefqet Dosku" Dorëz, për të realizuar një aktivitet mjedisor, siç është dhe mbjellja e disa fidanëve të llojit bredh i bardhë (*Abies alba*), në vendin e quajtur "Lugjet e Hysës", pjesë e Parkut Kombëtar "Shebenik". Në këtë mënyrë ne synojmë që të përçojmë tek brezat e rinjë informacionin se si të kujdesemi për natyrën duke e bërë gjithmonë e më të prekshme. Nëpërmjet aktiviteteve tona përpigemi të përcjellim tek ata dashurinë dhe kujdesin ndaj mjedisit, si një pjesë e rëndësishme e jona.

monument natyre guidë turistike shërbimi pyjorë
bredh i bardhë (*Abies alba*)



“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

AdZM Fier së bashku me ekspertët e Projektit JICA, në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Çermë-Sektor”, në Divjakë. Gjatë kësaj ore nxënësit u njohën me rëndësinë e edukimit mjedisor dhe mënyrat sesi ai zhvillohet në Parkun Kombëtar “Divjakë-Karavasta”.

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



17 janar 2024, Orë mjedisore

AdZM Gjirocastër në bashkëpunim me ZVA dhe shkollën jopublike "Xhuzepe Grass" në Gjirocastër, zhvilloi me fëmijët e klasës së tretë të kësaj shkolle një orë informuese e argëtuese me temë "Herbariumi". Informacioni i përcjellë tek nxënësit ishte për vlerat natyrore të Parkut Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli" si dhe koleksionimi i mostrave të gjethëve të grumbulluara nga parku. Kjo orë solli tek ta një mundësi për tu njohur me llojet e drurëve në Park.

24 Janar 2024, Eskursion mësimor

Në kuadër të projektit ndërlëndor Gjeografi-Fizikë-Kimi shkolla jopublike "Xhuzepe Grass" zhvilloi një eskursion mësimor në bashkëpunim me stafin e AdZM-së Gjirocastër në Parkun Natyror "Zagori". Ata u argëtuan dhe shijuan bukuritë e natyrës nën petkun e bardhë të dëborës.

31 Janar 2024, Orë mjedisore

AdZM Gjirocastër në bashkëpunim me ZVA dhe shkollën pedagogjike "Pandeli Sotiri" në Gjirocastër zhvilloi me fëmijët një orë mjedisore ku ndanë eksperiencat e tyre dhe u informuan nëpërmjet prezantimeve bashkëbiseduese me llojet e kafshëve të cilat ndodhen në Zonat e Mbrojtura.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇËS



26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimi Mjedisor

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Edukimit Mjedisor, u zhvillua një orë mjedisore në shkollën 9-vjecare "Sotir Gurra" të qytetit të Korçës. U zhvillua një prezantim për rëndësinë që ka edukimi mjedisor në brezin e ri, si dhe kujdesi që na duhet të tregojmë për natyrën që na rrethon. Nxënësit u ndanë në grupe duke marrë role të ndryshme profesioneve që lidhen me mjedisin dhe në situata të ndryshme ata demonstruan veprimet që do të ndërmerren në rastet e nevojshme në mjedis.

26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimi Mjedisor

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Edukimit Mjedisor, u zhvillua një orë mjedisore në shkollën "Kozma Basho". U zhvillua një prezantim mbi rëndësinë e kësaj dite.

27 janar 2024, Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

U realizua një orë mjedisore në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Shërbimit Pyjor, në shkollën 9-vjecare "Papa Kristo Negovani" të qytetit të Kolonjës. Inxhinierët e pyjeve improvizuan në ambientet e shkollës punën e tyre në pyje.

27 janar 2024, Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

Prezantim për Ditën e Shërbimit Pyjor në shkollën e Pustecit. I pranishëm ishte dhe një prej inxhinierëve tanë të pyjeve, ku shpjegoi një ditë pune në pyjet e Parkut.

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



16 janar 2024, Orë mjedisore

Pa pyje, ne nuk do të kishim ajër të pastër, ujë të pastër ose shumë nga ushqimet nga të cilat varem. Është e nevojshme të theksohet rëndësia e pyjeve për planetin tonë. Për këtë arsye, specialistët e AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Besëlidhja" kanë zhvilluar një orë mjedisore, për t'i treguar nxënësve gjithçka që duhet të dinë për rëndësinë e pyjeve, karakteristikat e tyre dhe shumë më tepër. Fëmijët zhvilluan disa pyetësor dhe renditën disa rregulla të sjelljes në pyll.

17 janar 2024, Orë mjedisore

Stafi AdZM Lezhë ka pritur në lagunë studentët e vitit të tretë të degës inxhinieri pyjore të Fakultetit Bujqësorë të Tiranës, të cilët po kryejnë praktikant në terren, duke u njohur me biodiversitetin e larmishëm dhe rëndësinë e zonës. Më pas zhvilluan vizitë në terren në disa nga pikat më tërheqëse të Lagunës së Vainit.

19 janar 2024, Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Lezhë kanë shoqëruar në lagunë studentët e masterit të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Studentët mundën të njihen me protokollet e monitorimit të faunës së egër, si dhe dolën në terren për t'i demonstruar ato.

26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimi Mjedisor

Në kuadër të ditës botërore të edukimit mjedisor, specialistët e AdZM Lezhë së bashku me nxënësit e shkollës së Mesme të Përgjithëshme "Ishull-Lezhë" zhvilluan një takim në mjediset e zyrave të institucionit, duke ndarë me të rinjtë e kësaj shkolle informacione mbi edukimin mjedisor. Ai është hartuar për të na mësuar se si të jetojmë në harmoni me natyrën dhe të zvogëlojmë ndikimin njerëzor në mjedis. Më pas punonjësit së bashku me nxënësit zhvilluan në kuadër të kësaj dite, një aktivitet pastrimi nga postoblloku Vain deri tek ura e Peshkatarëve.

**sjellja në pyll laguna e Vainit biodiversitet
protokollet e monitorimit ndikimi në mjedis**

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor zhvilluam një orë mjedisore me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Zef Jubani”, me të cilët diskutuam për rëndësinë e kësaj dite dhe jo vetëm.

27 janar 2024, Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

Në simbol dhe nderim të "Ditës Kombëtare të Shërbimit Pyjor" në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Pyjore "Kolë Margjini" mbollëm fidanë pishe në zonën e Taraboshit, pjesë e RNM Liqeni i Shkodrës.

“EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



11 janar 2024, Orë mjedisore

Stafi i AdZM Tiranë së bashku me nxënësit e shkollës fillore “Brar” realizuan një aktivitet mbjellje fidanësh të llojit pishë e zezë. Nxënësit morën pjesë në këtë aktivitet, duke dhënë kontributin e tyre gjatë procesit.

23 janar 2024, Orë mjedisore

Stafi i AdZM Tiranë realizoi një orë mjedisore bashkë me nxënësit e klasës së pestë të shkollës 9- vjeçare “Tufinë” në afërsi të Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”. Nxënësit morën informacion mbi vlerat natyrore dhe mjedisore të Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”. Gjithashtu ata u njohën me florën e pasur faunën e egër si dhe me monumentet e natyrës që përfshihen në park. Qëllimi i kësaj ore mjedisore ishte promovimi i vlerave dhe i bukurive natyrore të parkut dhe mbi të gjitha rëndësia për ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës kaq të bukur dhe të larmishme.

26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Edukimit Mjedisor, stafi i AdZM Tiranë realizoi një orë mjedisore me gjimnazin “Sami Frashëri” Tiranë, ku ndanë informacion mbi zonat e mbrojtura me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve, që do të jenë studentët dhe më pas ekspertët, të cilët do të ruajnë e promovojnë këto vlera kombëtare.

**pishë e zezë PK “Mali i Dajtit” ndërgjegjësim
promovim vlerash**

“EDUKIMI MJEDISOR”, VLORË



25 janar 2024, Orë mjedisore

AdZM Vlorë në bashkëpunim me Universitetin e Vlorës, dega Akuakulturë zhvilloi një orë mjedisore lidhur me ndikimin e sektorit të akuakulturës në gjirin e Vlorës dhe, mbi monitorimin e folenizimit të breshkave detare.

